



REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA E VUSHTRRIË

DATË/A	04.10.2022
PËRMES/PREKO/THROUGH	Kryetari të Komunës z. Ferit Idrizi
NGA/OD/FROM:	Drejtori i DEBPZHR-së z. Ergin Sungur
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	THIRRJE PËR APLIKIM

Për fermerët e Komunës së Vushtrrisë për përfitim në kuadër të implementimit të projektit: " Subvencionimi i bletëve".

I. Qëllimi i thirrjes për aplikim

Qëllimi i thirrjes për aplikim është njoftimi i të gjithë fermerëve mbarshues të bletëve, të Komunës së Vushtrrisë se Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural në kuadër të Programit për Zhvillimin e Bujqësisë 2022 do të subvencionojë fermerët që mbarshojnë bletë në shumën prej 4 €/ shoqëri bletësh.

II. Kriteret e përcaktuara

- Aplikuesi duhet të jetë banorë i Komunës së Vushtrrisë;
- Aplikues për pagesa direkte 2022;
- Të mbarshtojë së paku 30 shoqëri bletësh (koshere) dhe të shënuara qartë me Numrin Identifikues të Fermës(NIF).

III. Dokumentacioni i nevojshëm:

1. Kopja e letërnjoftimit;
2. Konfirmimi i bankës për posedim të Llogarisë bankare;
3. Deklaratën e nënshkruar për numrin e bletëve;
4. Vendimin për numrin e bletëve të aprovuar për pagesë nga ana e AZHB-së;

Kjo thirrje publike është e hapur për aplikim prej datës: 04.10. - 19.10. 2022.

Aplikacioni dorëzohet në zyrën e pranimi çdo ditë pune.